

Një numër i madh burrash nga fshatrat Sllup/Slup, Hereç/Ereç dhe Dujakë/Dujak u angazhuan në muajt mars dhe prill të vitit 1998 në bartjen e armatimeve nga Shqipëria në Kosovë. Në datën 20.04.1998, një grup prej 20 burrash [pjesëtarë të UÇK-së] ka kaluar në Shqipëri për një dërgesë të re armësh. Pas shkuarjes së tyre, familjarët nuk kishin njohuri për fatin e tyre për tri ditë rresht. Në datën **23.04.1998**, mediat kanë bërë të ditur se Selmani, Hajdari, Imer dhe Beqë Lokaj, Hasani, Sadiku, Shefqeti, Bekim Alijaj, Tahiri, Xhemajli, Bekim Mazrekaj, Hajdari, Vehbiu, Blerimi, Skënderi, Veliu, Uka, Gazmendi, Beka dhe Astriti kanë rënë në pusi të forcave serbe në rajonin e postbllokut ushtarak **Koshare/Košare**, gjatë kthimit nga Shqipëria në Kosovë. Që të gjithë kanë rënë në betejë që u zhvillua në mes të dy palëve. Po atë ditë, që të gjithë të vrarë nga Hereçi/Ereç u varrosën në varrezat e këtij fshati. Të rënë nga Sllupi/Slup u varrosën në varrezat e fshatit të tyre të lindjes. Trupi i Blerimit u gjet dy javë pas rënies së tij dhe u varros në varrezat e fshatit Dujakë/Dujak. Veli Noci, po ashtu, u varros në fshatin e lindjes në Dujakë/Dujak.

Burimet: deklarata N.A, FDH-12915; deklarata X.T, FDH-12916; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 22-26, FDHP-23816; *Bota Sot*, Lokaj Selmon, Lokaj Imer, përkujtimi në shtyp, 23.04.2006, FDH-8136; *Bota Sot*, Haderxhonaj Beke, përkujtimi në shtyp, 23.04.2006, FDH-8137; *Army releases names of 10 Albanians killed in Koshare*, newsletter, 26.04.1998, <http://www.hri.org/news/balkans>; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XX, 326-333; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Xhafer (Bekë) Kukaj

(2.04.1953, shqiptar nga Juniku/Junik, komuna e Deçanit/Deçani, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Gëzim (Miftar) Pepshi

(24.07.1977, shqiptar nga Juniku/Junik, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Xhaferi e kishte kryer shërbimin e rregullt ushtarak në APJ, në Slloveni. E studionte gjuhën angleze në Shkollën e Lartë në Prizren. I ka dhënë të gjitha provimet,

përveç diplomës. U inkuadrua në UÇK më 12.04.1998. Në datën **23.04.1998**, ata dy po ktheheshin nga Shqipëria, së bashku me një grup të madh ushtarësh të UÇK-së dhe me një ngarkesë armatimesh. Në vendin e quajtur *Boka e Popocit/Popovački kamenjar*, [**Popoc/Popovac**], ata kanë rënë në pritën e forcave serbe. Forcat serbe shtënë ndaj tyre. Xhaferi dhe Gëzimi u qëlluan për vdekje menjëherë. Pas 13 ditësh, pjesëtarë të UÇK-së kanë arritur që t'i tërhiqnin trupat e tyre dhe t'i varrosnin në mal. Pas përfundimit të luftës, mbetjet e tyre mortore janë rivarrosur me nderime ushtarake në varrezat e Junikut/Junik.

Burimet: H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Agim (Ismajl) Muja

(4.03.1970, shqiptar nga Kruma [Shqipëri], shofer, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Agimi aderoi në radhët e UÇK-së në vitin 1997. Ka marr pjesë në transportimin e armatimeve nga Shqipëria. Ka pësuar më **23.04.1998** në bjeshkën e *Pashtrikut/Paštrik*, në fshatin **Ujz**, në *Mëhallën Gradisht/Gradište*. Agimi ishte duke shkarkuar armatimet nga një kamion të madh në një më të vogël, kur një pushkë shkrepi aksidentalisht duke e qëlluar në kokë. Ka mbetur i vdekur në vend. E kanë varrosur më 24.04.1998 në varrezat e fshatit të tij të Krumës.

Izvor: deklarata H.M, FDH-40598; J. Osmani, *Krimet...*, II, 467.

Afrim (Emrush) Sylejmani

(7.03.1953, shqiptar nga Gjakova/Đakovica)

Afrimin e kanë parë të gjallë për herë të fundit më **26.04.1998**, kur e kishte sjell deri te dera e shtëpisë të vëllain Agimin, me veturë të tipit *Opel Corsa*. Një javë më vonë, Agimi ka mësuar se Afrimi ishte zhdukur [**Gjakovë/Đakovica**]. Më pas, po ashtu, dëgjoji se Afrimi ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Trupin e Afrimitit e kanë gjetur më 15.09.1998 në kanal in e ***Liqenit të Radoniqit/Radonjičko jezero***. Autopsia ka konstatuar se e kishin vrarë me një plumb në kokë dhe një tjetër në gjoks.